



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO			
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS			
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA			
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO			
Pranimar / Dorezuar Primijsenoi/Prudato Received/Delivery		11. 05 2021	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedimica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prifog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHTIK	2338	2021	113



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.205/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Ilire Mehmeti Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.205/2021, të datës 01.04.2021, të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi Rr."Enver Hadri" p.n, Komuna e Pejës, kundër organit të punësimit/Komuna e Pejës, në çështjen juridike "Vlerësimi i punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenin 47 dhe nenin 48 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 11.05.2021, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa numër A.nr.205/2021 e datës 01.04.2021 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi punësuar në Komunën e Pejës, me datë 01.04.2021 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 1523/2021, të regjistruar me numër A.nr.205/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim civil të Kosovës, kundër vlerësimit të rezultateve të punës, për vitin 2020.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 08.04.2021 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Komuna e Pejës. Këshilli me datë 16.04.2021 ka pranuar përgjigjën në ankese së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova; Ankesën me numër të protokollit 1523/2021 të regjistruar me numër A.nr. 205/2021 te parashtruar nga



ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 23.02.2021 të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues të mesëm të ulët dhe profesional; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 08.01.2020; Emalin e datës 10.03.2021; Emali i datës 12.03.2021; Kartelën e identifikimit me numër KPE-0053; Mirënjohjen e datës 23.05.2019; Letrën Reference të datës 24.01.2008; Certifikatën lidhur me trajnimin e datës 29.03.2001; Certifikatën lidhur me trajnimin e datës 03.11.2004; Emalin e datës 03.04.2021; Emali i datës 01.08.2021; Emalin e datës 13.03.2020; Emalin e datës 12.01.2020; Emalin e datës 11.12.2021; Mirënjohjen për ankuesin; Raportin e punës për periudhën kohore janar-dhjetor 2020; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 1602/2021 të datës 08.04.2021; Përgjigjen në ankesë me numër të protokollit 1830/2021 të datës 16.04.2021; Akt Emërimit e datës 01.01.2012 si dhe Përshkrimin e detyrave të punës; Planin e Punës për vitin 2020; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 09.01.2019;

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit *është e pa lejuar, sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës, respektivisht Akt Emërimit e datës 04.01.2012, rezulton se ankuesi është i punësuar në pozitën e punës Shef i Sektorit për Kulturë në Komunën e Pejës.

Drejtori i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Pejës, në cilësinë e udhëheqësit të drejtpërdrejtë, me datë 23.02.2021 ka bërë vlerësimin e rezultateve të punës për vitin 2020, për ankuesen, me c' rast të njëjtin e ka vlerësuar me notë të përgjithshme mirë (2.9).

Kundër formularit për vlerësimin e rezultateve të punës, të datës 23.02.2021, ankuesi me datë 01.04.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke u bazuar në provat e administruara të lëndës, respektivisht formularin e vlerësimit të rezultateve të punës të datës 23.02.2021, të dorëzuar nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ushtrimi i ankesës me datë 01.04.2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 13 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimit Publikë, ku përcaktohet se: 1. Nëse nëpunësi civil nuk pajtohet me vlerësimin përfundimtar të mbikëqyrësit, ka të drejtë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil. 2. Ndërsa nëpunësi i shërbimit publik ka të drejtë ankesë në Komisionin e ankesave të institucionit. 3. Afati për ushtrimin e ankesës së në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni është tridhjetë (30) ditë nga dita e marrjes së formularit të vlerësimit nga nëpunësi.

Andaj, duke u bazuar në nenin 129 paragrafi 1 nen paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe nenin 18 paragrafi 1 nen paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.


Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore



në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A.nr.205/2021

Ilire Mehmeti-Shaqiri


Procesmbajtëse



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Pejës
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Pejës
- Arkivit të KPMSHCK-së

